

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit dhe anëtarëve të trupit gjykues-gjyqtarët Vehbi Kashtanjeva dhe Lumnije Krasniqi me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuarit G.K. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë PP.nr.857-5/10 të dt: 20.01.2012 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë verbal e publik me dt: **09.06.2016** të njëjtën ditë bjenë në prezencë të prokurorit të shtetit Fitore Sadikaj, të akuzuarit G. K. dhe mbrojtjes av.T. Zh., publikisht shpallë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

G. K., me nofken "G." nga i ati V. dhe e ema R., i vajzerise G., i lindur me dt: *data e lindjes...*, në P., me nr. personal të ID-së: *numër personal...*, ku dhe tani jeton ka të kryer shkollën e mesme, bashkpronar i firmës "H.-K." me ujë, i martuar, baba I dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas I Republikës së Kosovës

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me daten 03.10.2010 rreth ores 21:15 min ne restorantin "C. C." ne Bregun e Diellit në Prishtinë ka perdorur armen me frikësim dhe kërcenim,në menyrë të pa autorizuar,në atë menyrë që pistoleten ilegale "Blow" me nr.serik 7-006720 të kalibrit ,6.35 mm pasi e ka rapertirat,ia ka drejtuar kater personave dhe I ka mbajtë në shenjester derisa është larguar nga vendi I ngjarjes,

-me çka ka kryer vepren penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 parg 1 të KPK-së

Andaj gjykata në kuptim të neneve: 2,3,4,17,41,42, ,49,51,52, 62,73 të KPRK-së dhe nenit 365, 450 dhe 463 te KPPRK-së

Të akuzuarit **G. K.**

Për veprën Mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPRK-së, i shqipton **DENIM ME KUSHT – DENIM**

BURGU në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, i cili denim nuk do të ekzekutohet nëse i gjykuari në afat prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

DENIMI PLOTËSUES

Konform nenit 62 par.2 nën par. 2.7 të KPK-së ndaj të akuzuarit **G.K.** konfiskohet pistoletë e markës “Blow” me nr.serik 7-006720 të kalibrit 6.35mm, një karikator, katër fishek të kalibrit 6.35 dhe një fishek të të njëjtit kalibër .

I akuzuari **G.K.** obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga **100 (njqind) Euro**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi

A r s y e t i m

Ish Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzë PP.nr.857-5/10 të dt: 20.01.2012 kundër të akuzuarit G. K. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësorë me dt:09.06.2016. Pas deklarimit të akuzuarit G. K. se e pranonë fajsinë për veprën penale e cila i vëhet në barrë, i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, me të cilin pranim është pajtuar edhe prokurori i shtetit.

Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 248 par.1 i KPPRK –së, pikërisht se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe është rezultat i konsultave me mbrotësen av. T. Zh. , se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialin e prezantuar nga prokurori i shtetit, të pranuar nga i akuzuari. Prandaj gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, sepse janë përmbushur kushtet për pranimin e fajësisë nga neni 248 par.1 të KPPRK –së

Gjykata paraprakisht të akuzuarin e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjtit do të shpallët fajtorë për veprën e cekur më lartë dhe do t’i shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, mirëpo gjykata gjatë marrjës së vendimit mbi denimin, do ta ketë parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë letësuese.

Duke e marr parasysh se në shqyrtimin gjyqësorë ka ardhur deri te pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata pa prezentimin e provave ka kaluar në fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja i shtetit Fitore Sadikaj në fjalën përfundimtare deklaroi se I akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor e pranoi fajsinë për veprën penale nga neni 328 par.1. të KPRK-së, pranim ky i fajësisë I cili është në përputhje me prova që egzistojnë në shkresat të lëndës, andaj I ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta denoj sipas

ligjit, mirëpo gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së denimit, pranimit e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Mbrotsja e të akuzuarit av. T. Zh. në fjalën përfundimtare ka thekësuar se I akuzuari G. K. në seancën e shqyrtimit gjyqësorë ka pranuar fajsinë për veprën penale që I vëhet në barë, duke qenë I vetëdijëshëm për pranimit e fajësisë dhe për pasojat që lidhen me pranimit e fajësisë. E ka lutë gjykatën që gjatë përcaktimit për llojin dhe lartësinë e denimit të merr parasysh pranimit e fajësisë si rrethanë posaqërisht lehtësuese duke marr ndaj të klientit të saj, një denim sa ma të butë.

I akuzuari G. K. në fjalën përfundimtare deklaroi se e në tërsi e përkrahë fjalën përfundimtare të avokatës, duke shtuar se I vjen keq për rastin që ka ndodh dhe e ka lutë gjykatën që ndaj tij të shqipton një denim sa më të butë sepse tani është prindi I dy femive dhe prej këtij rastit asnjherë nuk ka ardhur në kundërshtim me ligjin.

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarit morri parasysh pranimit e fajësisë dhe pendimin e thellë të shprehur gjatë shqyrtimit gjyqësorë si rrethanë veqanarisht lehtësuese, sjelljen korrekte të njejt, ka të kryer shkollën e mesme I pa punë, babai I dy femive, I gjendjes së dobët ekonomike. Nga rrethanat rënduese gjykata asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtorë dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se denimi I shqiptuar I përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njejt do të shërbejë si preventivë individuale dhe gjenerale dhe parandalim se në të ardhmën nuk do të kryen vepra penale, duke ndikuar në rehabilitimin e tij.

Gjykata është e bindur se me denimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi denimin plotësues gjykata e ka bazuar në nenin 62 paragraf 2 nënparagraf 2.7 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 450 paragraf 2 nënparagraf 2.6 të KPRK-së.

Nga se u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
P.nr.379/12, të dt. 09.06.2016

Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj

Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.